



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.5.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË LIBOHOVË QARKU GJIROKASTËR,
Z.LEONARD VYRITYT HIDE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023**

Sot më datë 23.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, Qarku Gjirokastrë, z. Leonard Vyrtyt Hide, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, neni 33, shkronja "g" dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Data: . .2023 Nr: 00
Ora:



"Për dhënie e mandatit të Kryetarit të bashkisë Libohovë, qarku Gjirokastrë, z.Leonard Vyrtyt Hide, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 81 me vendimin nr.64, datë 15.5 .2023, ka shpallur fitues z. Leonard Vyrtyt Hide, si Kryetar i bashkisë Libohovë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, nenin 33, shkronja “g” dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, Qarku Gjirokastrë, z. Leonard Vyrtyt Hide, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: . .2023 Nr:
Ora:



“Për dhënien e mandatit të Kryetarit të bashkisë Libohovë, qarku Gjirokastrë, z.Leonard Vyrtyt Hide, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”